

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal**, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me procesmbajtësen Drita Ujupi në këtë gjykatë në lëndën penale kundër të akuzuarit I.A. nga fshati ..... komuna Shtërpcës, i akuzuar sipas Propozimkuzës së ish Prokurorisë Komunale në Ferizaj PP.nr.2414/11 të dt.05.04.2012 për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datën 21.04.2017 në prezencën e Prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit I.A., publikisht shpalli dhe komunikoi, ndërsa me datë 02.05.2017 përpiloi me shkrim këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **Kundër të akuzuarit:**

**I.A.**, nga fshati ..... komuna Shtërpcë, ....., nga i ati M. dhe e ëma H....., pensioner, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. Personal .....

**Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së,**

### **REFUZOHET AKUZA**

Sepse me datë 25.07.2011, në banesën e tij në Ferizaj, në rrugën "Rexhep Bislimi", në Ferizaj, gjatë kontrollit nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut, divizioni i rjetit në Prishtinë, sektori qendra e kalibrimit, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, ka shfryrëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, në atë mënyrë që në njehsorin elektrik nr.012839, është dëmtuar fizikisht ashtu që numëruesi i njehsorit është i manipuluar, me qëllim të mos regjistrimit të energjisë elektrike së shpenzuar, me të cilin veprim ka dëmtuar KEK-un, distrikti në Ferizaj në shumë prej 149.64€.

Me që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza për veprën penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale.

E dëmtuara KEK- distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale biejn në barrë të mjeteve buxhetore.

## **A r s y e t i m**

Ish Prokuroria Komunale në Ferizaj me propozimkuzën PP.nr.2414/11 të datës 05.04.2012 e ka akuzuar I.A. nga Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datën 21.04.2017, ku pas administrimit të provave prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se tërhiqet nga ndjekja penale për veprën penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPRK-së, për shkak s nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

E dëmtuara KEK- distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 454 par.1 të KPK -së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e sipërcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI  
PËRGJITSHËM – DIVIZIONI PENAL  
P nr.339/12 të dt. 02.05.2017**

**Sekretarja juridike,  
Drita Ujupi**

**Gjyqtari individual,  
Mustaf Tahiri**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kpjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.